



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Qendra Kombëtare e Biznesit, ka të administruar në rrugë elektronike, kërkesën e Qendrës “ Res Publica”, me numër 18/25 prot., , me lëndë : “ *Kërkesë për informacion dhe dhënie dokumentacioni*”.

Bazuar në ligjin nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit”, Qendra Kombëtare e Biznesit, informon si më poshtë vijon:

NIPT është përcaktuar si Numri Identifikimit të Personit të Tatuashëm. Aktualisht me hyrjen në fuqi të ligjit nr.9723/2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, është përcaktohet si NUIS, Numri Unik i Identifikimit të Subjektit.

Shoqëritë tregtare apo personat fizik të regjistruar në administratën tatimore apo në Qendrë Komëbtare të Biznesit si subjekte tregtare pajisen me numër identifikimi unik (NUIS), të gjeneruar nga sistemi, i cili shërben si numër i identifikimit tatimor të tyre, për tatimet kombëtare dhe vendore.

*1. Lidhur me kërkesë tuaj për dhënien inforamcion mbi strukturën e NUIS dhe si përfaqësohen ato, bëjmë me dije si vijon:*

NUIS i caktuar për tatimpaguesit, përfshirë personat juridikë dhe fizikë të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndjek formatin si vijon J12345678N.

Karakterit i parë është një shkronjë e madhe që tregon dekadën e lëshimit të numrit të identifikimi (p.sh., "J" për 1990-1999, "K" për 2000-2009).

Karakterit i dytë Tregon vitin brenda dekadës së caktuar (p.sh., 1 për 2011, 2 për 2012).

Karakteret e tretë dhe të katërt nënkuptojnë muajin e konvertuar të lëshimit të NUIS, në varësi të rrethit ku biznesi është krijuar fillimisht. Për shembull, janari në Tiranë përfaqësohet me 13, shkurti në Tiranë me 14, janari në një rreth tjetër me 25, shkurti në atë qark me 26, e kështu me radhë.

Karakteret e pesta dhe të gjashta përfaqësojnë ditën e muajit në të cilin është lëshuar NUIS (p.sh., 01, 02, 03, etj.).

Karakteret nga 7 deri në 9 tregojnë rendin vijues të lëshimit të NIPT-it në ditën e caktuar brenda një rrethi të caktuar (p.sh. 009 është NIPT-i i 9-të i lëshuar në qarkun e Tiranës, 108 është NIPT-i i 8-të i lëshuar në një qark tjetër).

Karakterit i dhjetë është një shifër kontrolluese, një shkronjë e madhe e llogaritur në bazë të një formule që varet nga nëntë karakteret e para. Sqarojmë se karakterit fundor i NUIS gjenerohet në mënyrë rastësore. Njëkohësisht, sjellim në vëmendje tuaj se, referuar nenit 60 të ligjit nr.9723/2007 “ Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, është përcaktuar se, me regjistrimin në regjistër,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

subjekteve u jepet numri i identifikimit, i cili gjenerohet në mënyrë elektronike nga QKB-ja dhe është unik për çdo subjekt të regjistruar. Numri unik i identifikimit të subjektit është i vlefshëm për identifikimin e subjekteve, për qëllimet e regjistrimit në regjistër, për qëllimet e regjistrimit si person i tatueshëm pranë autoriteteve fiskale, qendrore dhe vendore, për skemën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për autoritetet e inspektimit të marrëdhënieve të punës, si dhe për çdo qëllim tjetër statistikor ose identifikues. Numri unik i identifikimit të subjektit jepet vetëm një herë, në çastin e regjistrimit fillestar dhe është i pa ndryshueshëm, si dhe nuk u jepet subjekteve të tjera edhe pas çregjistrimit.

- 2. Sa i takon pyetjes tuaj se a përmban NUIS një mekanizëm për kontrollin e vlefshmërisë të tij, p.sh, me anë shifrash të dedikuara të përlogaritura nga pjesa tjetër e tij (Check digit) sqarojëm se:*

Nuk është përcaktuar një mekanizëm i cili do të kontrollonte vlefshmërinë e NUIS të lëshuar nga organet kompetente në format check digit. Sikurse e kemi deklaruar edhe më sipër, formati mbi të cilin gjenerohet NUIS, përmban të dhënat që nga dekada në të cilën është lëshuar ky numër, deri tek të dhënat e muajit apo ditës në të cilin është gjeneruar NUIS, të dhëna këto të cilat janë unik për secilin subjekt.

- 3. Lidhur me pyetjen tuaj se cili është burimi ku janë përcaktuar këto detaje, bëjmë me dije se:*

Baza ligjore e cila zbatohet në lidhje me pajisjen e subjekteve e NUIS, është ligji nr.9723/2007 “ Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, e më konkretisht neni 60 i tij , në të cilin është përcaktuar në mënyrë të qartë procedura e pajisjes me numrin unik të identifikimit të subjektit, pasi ky i fundi është regjistruar në regjistrin tregtar.

Në përfundim Qendra Kombëtare e Biznesit, është e hapur për vënien në dispozicion të informacioneve shtesë, brenda fushës së saj të përgjegjësisë, lidhur me kërkesat tuaja.

Faleminderit.